



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Gjashtë i Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE6 (2012-2013)

Raporti Konsultativ për KOSTT-in

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të marrjes së komenteve eventuale nga palët e interesit. [Ai nuk paraqet vendim të ZRRE-së.](#)

27 shkurt 2012

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Alokimi i kostos lidhur me nënstacionet 110 kV	2
3	Struktura e këtij dokumenti	3
4	Balanca e energjisë	3
5	Përshtatjet	4
5.1	Amortizimi i asetëve	5
5.2	Ndryshimi i RABf	5
6	Bashkërenditja	5
6.1	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes	5
6.2	Shpenzimet kapitale	5
7	Propozimet e ZRRE-së	6
7.1	Shpenzimet për personelin	6
7.2	Shpenzimet e mirëmbajtjes	6
7.3	Shpenzimet shtesë për shërbime	6
7.4	Shpenzimet tjera	7
7.5	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit	7
8	Përmbledhje	7

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është aktualisht në procesin Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6). Procesi i shqyrtimit të tarifave ngërthen përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që të licencuarit në shqyrtim i lejohet të mbledhë për shërbimet e rregulluara që ofron. MAR-i i përcaktuar me këtë shqyrtim pritet të hyjë në fuqi që nga 1 prilli 2012.

Ky Raport Konsultativ parashtron këndvështrimin e ZRRE-së lidhur me kërkesën e KOSTT-it për të Hyra Maksimale të Lejuara për komponentet e Operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut. Kërkesat janë botuar në faqen e internetit të ZRRE-së së bashku me këtë Raport Konsultativ.

ZRRE fton palët e interesit që të ofrojnë komente rreth qëndrimeve të veta të shprehura në këtë Raport Konsultativ. Komentet përkritazi me këto propozime do të pranohen deri më 12 mars 2012 dhe duhet të dërgohen me postë elektronike në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, me titullin “Komentet për SHTE6”, ose me postë në adresë të ZRRE-së: Rr. Hamdi Mramori nr.1, 10000 Prishtinë, Kosovë, ku në rubrikën e lëndës të shkruhet për “Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave”.

Në këtë fazë, ZRRE nuk ka marrë vendim mbi MAR i cili do të hyjë në fuqi më 1 prill. Këto janë propozime preliminare. ZRRE fton të gjitha palët e interesit të japin komente mbi këndvështrimet e ZRRE-së të parashtruara në këtë dokument.

2 Alokimi i kostos lidhur me nënstacionet 110 kV

Më 3 gusht 20011, Qeveria e Kosovës ka vendosur t’i transferojë të gjitha asetet 220/35/10(20) kV dhe 110/x kV KOSTT-it. Vendimi cek se të gjitha asetet dhe punëtorët që punojnë në këta transformatorë të barten nga KEK-u te KOSTT-i.

Si KEK-u ashtu edhe KOSTT-i i kanë përfshirë vlerat e këtyre asetëve në kostot e ndërlidhura operative dhe të mirëmbajtjes në kërkesën e tyre për tarifë.

Në një takim të mbajtur në lokalet e ZRRE-së më 23 janar 2012, KOSTT-i pohon se grupi punues për implementimin e vendimit të qeverisë për bartjen e asetëve gati ka përfunduar të gjitha detyrat dhe marrëveshjet lidhur me bartjen e asetëve. Sipas KOSTT-it, implementimi tash varet nga finalizimi dhe këto asete duhet t’i barten KOSTT-it duke filluar nga 31 janari 2012. KEK-u, në anën tjetër, pohon¹ se deri më sot, asnjë punëtor dhe asnjë transformator nuk i janë bartur KOSTT-it nga KEK-u dhe se nuk kanë informata mbi vlerën e kostove operative dhe të mirëmbajtjes të cilat janë të ndërlidhura me transferin. KEK-u shton se nuk beson që kjo të jetë e mundur të kryhet shumë shpejtë.

ZRRE konstaton se kostot e ndërlidhura me këto asete duhet t’i alokohen ose KOSTT-it ose KEK-ut por jo të dyve. Duke marrë parasysh se nuk është e sigurt nëse transferi është bërë apo jo, si dhe

¹ Takimi është mbajtur në lokalet e KEK-ut më 26 janar 2012.

ndryshimet në kosto të ndërlidhura të punës dhe mirëmbajtjes, ZRRE propozon që këto kosto, tash për tash, t'i alokohen vetëm KEK-ut.

3 Struktura e këtij dokumenti

Ky Raport Konsultativ është i organizuar si në vijim:

- Në pjesën 4 shtjellohet Balanca e Energjisë për vitin 2012
- Në pjesën 5 shqyrtohen propozimet e KOSTT-it lidhur me të Hyrat maksimale të lejuara (MAR) të Operatorit të sistemit të transmisionit.
- Në pjesën 6 shqyrtohen propozimet e KOSTT-it lidhur me MAR-in për Operatorin e tregut.
- Në pjesën 7 jepet një përmbledhje e propozimeve të ZRRE-së lidhur me tarifat e rregulluara që do të vlejnjë prej 1 prilli 2011.

4 Balanca e energjisë

Balanca e Energjisë e përdorur për qëllime të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara krijohet duke përdorur qasjen nga poshtë-lartë. Së pari, vlera e shitjeve përfundimtare të energjisë për konsumatorët e distribucionit merren nga Balanca e Energjisë e cila aprovohet nga MZHE², i ndryshuar krahas rritjes së shitjeve të ndërlidhura me uljen e humbjeve teknike dhe komerciale. Vlera e humbjeve të distribucionit të lejuara nga ZRRE dhe prodhimi i lidhur në distribucion pastaj i shtohen kësaj shifre, dhe fitohet shifra e energjisë që hyn në distribucion. Shuma e kësaj vlere, humbjet në transmision dhe konsumi i transmisionit pastaj krahasohen me prodhimin vendor të lidhur me transmision dhe eksportet. Dallimi ndërmjet tyre mbulohet nga importi.

ZRRE ka zbritur humbjet e kërkuara nga KOSTT-i e që asocohen me transferin e aseteve 110kV, në përputhje me vendimin e ZRRE-së që t'i alokojë të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me bartjen KEK-ut deri në rishqyrtimin tarifor të radhës. Niveli i lejuar i humbjeve për KOSTT-in prandaj është 118.0 GWh që është rreth 2.07% e tërë energjisë që hyn në sistemin e transmisionit. Kostoja e blerjes së energjisë ka ndryshuar nga ajo e supozuar nga KOSTT për arsye të ndryshimit të ponderimit dhe të çmimeve të propozuara nga ZRRE, të cilat dallojnë nga ato të supozuara nga KOSTT.

Përmbledhja e Balancës së Energjisë të cilën ZRRE ka marrë parasysh në llogaritjen e MAR-it për KOSTT-in është dhënë në tabelën vijuese:

² Ministria për zhvillim ekonomik

Përshtatjet

		-- 2012 -- Aplikimi	-- 2012 -- Propozimi I ZRRë
Gjenerimi			
Gjenerimi I KEK-ut			
Kosova A	GWh	1,552.3	1,475.3
Kosova B	GWh	3,470.2	3,392.5
Gjenerimet tjera vendore			
HPP Ujmani	GWh	82	82
Shperndarja nderlidhur-gjenerimi	GWh	52	52
Iportet dhe Eksportet			
Importet	GWh	824.7	800.8
Eksportet	GWh	-169.8	-183.7
Humbjet ne Transmision			
Humbjet e transmisionit	%	2.23%	2.07%
	GWh	132.2	119.0
Kerkesa në Transmision			
Shitjet per konsumatorët e kyçur në transmision			
220kV (Feronikeli)	GWh	657.0	657.0
110kV (perfshire Trepca)	GWh	87.6	87.5
Konsumi I KEK-ut	GWh	299.4	131.4
Humbjet ne shperndarje dhe energjia e pafaturuar			
Humbet ne shperndarje dhe energjia e pafaturuar	%	37.19%	35.04%
	GWh	1,723.8	1,619.9
Kerkesa e kyçur në Shpërndarje			
Shitjet tek klientet e kyçur në shperndarje	GWh	2,910.9	3,003.6
Balanca	GWh	0.0	0.0

Tabela 1: Balanca e Energjisë që është përdorur për llogaritjen e të hyrave të lejuara

5 Përshtatjet

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ shtjellon ndryshimet që ZRRE i ka bërë kërkesës së KOSTT-it. ZRRE nuk ka dhënë ndonjë gjykim mbi arsyeshmërinë e kërkesës së KOSTT-it në këtë pjesë. Qëllimi i ndryshimeve është të prezantohen ndryshimet në kërkesën e KOSTT-it të cilat janë bërë për shkak se kërkesa nuk ishte në përputhje me praktikën, rregullat apo rregulloret e mëhershme të ZRRE-së.

5.1 Amortizimi i asetëve

KOSTT-i ka ngritur vlerën e RAB-it që përdoret për të llogaritur inflacionin jo vetëm me vlerën e asetëve para 2006, por gjithashtu edhe për vlerën e amortizimit që i është shkaktuar asetëve të KOSTT-it në vlerësimin e vet të fundit të asetëve (2005).

ZRRE rrjedhimisht ka mbajtur takim me KOSTT-in në të cilin ZRRE ka shpjeguar se vlera përfundimtare e asetëve, përfshirë amortizimin, duhet të përdoret për qëllimet të llogaritjes së të hyrave të lejuara me SHTE6 dhe ka sqaruar se kjo është në pajtueshmëri me trajtimin e këtyre asetëve nga KOSTT-i në pasqyrat e tyre statusore. ZRRE prandaj ka ndryshuar pjesën e RAB-it të KOSTT-it në kërkesën e tyre.

Ky ndryshim ka ulur shtesat për amortizim për të KOSTT-it për €1 milion.

5.2 Ndryshimi i RABf

ZRRE vëren se KOSTT ka vendosur vlerën e RABf-it si ka qenë në modelin e të Hyrave dhe Tarifave të SHTE5. ZRRE ka rregulluar këtë vlerë duke marrë parasysh pasqyrat e audituara financiare të KOSTT-it.

Ky ndryshim ka rritur të hyrat e lejuara për KOSTT-in në vlerë prej €0.25 milionë.

6 Bashkërenditja

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ prezanton ndryshimet në të hyrat e lejuara që paraqiten ndërmjet vlerave të lejuara nga shqyrtimet paraprake të tarifës dhe vlerave reale të raportuara nga KOSTT-i sipas shqyrtimit aktual të tarifës.

6.1 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

ZRRE ka vërejtur një dallim ndërmjet vlerave të Shpenzimeve operacionale të lejuara vitin e kaluar me ato të raportuara në SHTE6. Për shkak të praktikave të ndryshme të kontabilitetit, nuk mund të bëhet krahasimi i kostove sipas zërave. Përkundër kësaj, ZRRE konsideron se është e qëlluar që të barazohet shuma e kostos së mirëmbajtjes dhe materialeve dhe shërbimeve ndërmjet atyre të lejuara dhe reale dhe këto t'iu kthehen konsumatorëve.

Ky barazim ka ulur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për € 0.3 milionë .

6.2 Shpenzimet kapitale

ZRRE vëren se KOSTT-i në masë të madhe ka shpenzuar më pak për shpenzime kapitale në krahasim me nivelin e lejuar me SHTE5. Sipas SHTE5, KOSTT-i ka marrë një fitim të lejuar dhe amortizim për një shumë të parashikuar investimesh prej €26.3 milionë. KOSTT-i në fakt ka investuar vetëm €11 milionë gjatë SHTE5. Si zakonisht, ZRRE do të barazojë dallimin ndërmjet nivelit real dhe të lejuar në këtë shqyrtim tarifor.

Ky barazim ka zvogëluar të hyrat e lejuara për KOSTT-in për €0.3 milionë.

7 Propozimet e ZRRE-së

Kjo pjesë e Raportit Konsultativ prezanton ndryshimet në MAR që paraqiten nga vlerësimi i ZRRE-së mbi arsyeshmërinë e inpueteve të kërkuara nga KOSTT-i në kërkesën e tyre për tarifën.

7.1 Shpenzimet për personelin

KOSTT-i ka kërkuar gjithsej shpenzime për personel prej €4.4 milionë krahasuar me €2.2 milionë të lejuar nga ZRRE në STE5. KOSTT-i ka shpjeguar se kjo rritje në shpenzimet për personel janë të ndërlidhura me bartjen e 135 punëtorëve nga KEK-u te KOSTT-i, në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për transferimin e aseteve.

Pasi që ZRRE supozon se këto shpenzime i janë alokuar KEK-ut me këtë shqyrtim tarifor, vlera prej €1.4 milionë, e lidhur me bartjen e aseteve, është zbritur nga shuma e lejuar. Për më tepër, ZRRE konsideron se shpenzimet e lejuara për personel të KOSTT-it duhet të jenë barazi me ato të lejuara me SHTE5, të ndryshuar vetëm për numrin e shtuar të punëtorëve me pagë mesatare të aprovuar nga ZRRE me SHTE5. Shpenzimet e lejuara të personelit për KOSTT-in prandaj janë €2.5 milionë. ZRRE inkurajon KOSTT-in që të rris efikasitetin e pagave në përputhje me kushtet e tregut në Kosovë.

Ky propozim ka ulur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për €1.9 milionë.

7.2 Shpenzimet e mirëmbajtjes

KOSTT-i ka kërkuar €1.5 milionë për Shpenzime të mirëmbajtjes, që është gati 100% rritje prej shpenzimeve të vitit 2011.

ZRRE supozon se pjesa më e madhe e rritjes në këto shpenzime është për shkak të bartjes së aseteve prej 110kV nga KEK-u në KOSTT. Ashtu siç u shpjegua më lartë, për shkak të supozimit se këto shpenzime i janë flokuar KEK-ut gjatë këtij rishqyrtimit tarifor, ZRRE i kalon konsumatorëve të skajshëm një vlerë prej €1.1 milionë , që iu përgjigjet niveleve të lejuara me SHTE5.

Ky propozim ka ulur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për €0.4 milionë.

7.3 Shpenzimet shtesë për shërbime

KOSTT-i ka kërkuar €1.6 milionë për shpenzime shtesë për shërbime ndihmëse nën pretendimin se këto janë shpenzime për ofrimin e shërbimeve ndihmëse nga Kosova A dhe Kosova B.

Në përputhje me vendimet e mëhershme, ZRRE propozon që kjo vlerë të mos lejohet në të hyra të lejuara pasi që aktualisht nuk ka shpenzime që shkaktohen në këtë kategori, në mungesë të kontratave për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Përmbledhje

Ky propozim ka ulur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për €1.6 milionë.

7.4 Shpenzimet tjera

KOSTT-i ka kërkuar një vlerë prej €1.8 milionë për shpenzime të tjera operative. KOSTT-i i ka shpjeguar ZRRE-së se këto shpenzime janë rritur si rezultat i rritjes së numrit të personelit.

Duke qenë se ZRRE ka vendosur që shpenzimet e ndërlidhura me bartjen e aseteve t'i alokohen KEK-ut, ZRRE propozon që kategoria e *Shpenzimeve të tjera* të caktohet barazi me shumën e vlerës së lejuar me SHTE5 dhe shpenzimeve të sigurimit prej €0.25 milionë.

Ky propozim ka ulur të hyrat e lejuara për KOSTT-in për €0.3 milionë.

7.5 Mesatarja e Ponderuar e Koshtos së Kapitalit

KOSTT ka kërkuar Mesatare të Ponderuar të Koshtos së Kapitalit në vlerë prej 13.8% reale para taksës, që nënkupton 16.8 nominale para taksës.

ZRRE thekson se kjo kërkesë e KOSTT-it nuk është në pajtim me Vendimin e ZRRE-së për Vlerat Indikative të Mesatares së Ponderuar të Koshtos së Kapitalit. Për qëllim të llogaritjes së të Hyrave të Lejuara të KOSTT-it, ZRRE ka përdorur MPKK-në që është caktuar nga Bordi i ZRRE-së në atë Vendim. Ky nivel i MPKK-së (11.5% real para tatimit) është caktuar nën supozimin se niveli i leverazhit të KOSTT-it është 0.5. Në fakt, niveli i leverazhit të KOSTT-it mund të ndryshojë nga vlera e parasupozuar e ZRRE-së. Për këtë arsye, KOSTT duhet t'i ofrojë ZRRE-së të dhëna lidhur me nivelin e leverazhit të realizuar nga KOSTT.

Për më tepër, në Shtojcën 3 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut thuhet se në llogaritjen e MPKK-së merret parasysh kostoja e realizuar e borxhit. KOSTT-i i ka ofruar ZRRE-së të dhëna lidhur me normën e interesit të një kredie, megjithatë ZRRE pret që KOSTT-i të marrë parasysh saktësisht kërkesat e Rregullës në fjalë dhe të ofrojë llogaritje të koshtos së realizuar të borxhit.

Kjo ndërhyrje e ZRRE-së ka reduktuar të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it për €0.4 milionë.

8 Përmbledhje

ZRRE thekson se – varësisht prej ndryshimeve, barazimeve dhe propozimeve të ZRRE-së – shuma e të Hyrave të Lejuara për KOSTT-in mund të arrijë €14.8 milionë. Vlera e Të Hyrave të Lejuara të KOSTT-it në SHTE5 ishte €12.8 milionë.